**VENDIM**
**Nr. 321, datë 11.6.2025**

# PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 61, DATË 29.1.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të dhënat e pasurisë me numër rendor 1 të tabelës, bashkëlidhur vendimit nr. 61, datë 29.1.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i fiderave me kabllo 20 kV, V4, V5 dhe kabinave të reja nga nënstacioni i ri Valias"", zëvendësohen me të dhënat e pasurisë me numrin rendor 1 të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.
3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë Vorë, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Belinda Balluku**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I FIDERAVE ME KABLLO 20 kV, V4, V5 DHE KABINAVE TË REJA NGA NËNSTACIONI I RI VALIAS"

| NR. | Nr. i shtyllës | PRONARI | | | TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË) | | | | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM | | | | SHËNIME *(Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë, etj.)* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | "ARË"/ TRUALL | | | VLERA TOTALE (lekë) | |
| | | Emër | Atësia | Mbiemër | Fshati ose qyteti | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja totale | Volumi | Faqe | Sipërfaqja (m²) | Çmimi (lekë/m²) | Vlera (lekë) | | |
| 1 | K2/V4 | Luan | Hysni | Mërkuri | Valias | 1649 | 18/23 | Are | 3785.2 | 18 | 187 | 24 | 5455 | 130920 | 130920 | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | |